

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPK	Nr Prot	03-03/1974/20
Dep.		Br Prot	
Dep.		Prot Nr	
Nr. I tarj		Data	28-09-2020
Broj stranice	03	Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATE/A:	28/09/2020
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1916/20
PËR/ZA/TO:	Z. Shaban Tafa Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
CC:	z. Nenad STOJCETOVIC Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komunitete në nevojë"



I nderuari z.Tafa,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "**Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komunitete në nevojë**", me numër të prokurimit: 211-20-5436-5-1-1, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211/20/011/511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: "**Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komunitete në nevojë**", me numër të prokurimit: 211-20-5436-5-1-1, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211/20/011/511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të

Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 22/09/2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: DPK 03-03/1916/20, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit dhe komunitete në nevojë**", me numër të prokurimit: 211-20-5436-5-1-1, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211/20/011/511, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria për Komunitet dhe Kthim.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur kontratë të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar prej 4,500,000.00€.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka vërejtur se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional autoriteti kontraktues ka kërkuar: *OE duhet të ketë të deklaruar në ATK punëtor min. 50 punëtor gjatë vitit 2020. Dëshmia e kërkuar dokumentare: OE duhet të dorëzojë Lista nga punëtorëve si dhe kontratat mes OE dhe punëtorëve.* Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.

Sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues mund të kërkojë minimumin e mesatares së fuqisë punëtorë dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet e fundit, ku si dëshmi mund të kërkojë një deklaratë apo raport për fuqinë mesatare punëtorë dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një kërkesë e tillë e vendosur nga Autoriteti kontraktues është diskriminuese dhe nuk u mundëson operatorëve tjerë të cilët kanë një numër minimal të fuqisë punëtorë të ofertojnë për këtë kontratë. Duke caktuar një kufizim të tillë autoriteti kontraktues favorizon vetëm operatorët ekonomik të cilët kanë këtë numër të të punësuarve ose më tepër dhe në këtë mënyrë i eliminon operatorët tjerë të cilët kanë një numër të kënaqshëm të të punësuarve. Duke caktuar një kërkesë të tillë autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik, ku sipas këtij ligji thuhet se "*Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik*".

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

